

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice*

Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Korrekcional Service  
*Drejtoria e Përgjithshme*



## SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

Raport vjetor 2022

Shërbimi Korrektues i Kosovës

Publikuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

<b>Përmbajtja</b>	
Lista e shkurtesave .....	5
Fjala hyrëse nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm.....	6
<b>Pjesa e Parë.....</b>	<b>7</b>
Përmbledhja ekzekutive.....	7
Misioni.....	8
Vizioni.....	8
Mandati.....	8
<b>Pjesa e Dytë.....</b>	<b>9</b>
Vështrim i Përgjithshëm.....	9
Transparenca.....	9
<b>Pjesa e Tretë.....</b>	<b>10</b>
Çështjet Ligjore.....	10
Ligjet e miratuara.....	10
Aktet nënligjore të miratuara.....	10
Projekt aktet nënligjore.....	10
Kërkesat për faljen e dënimit.....	10
Kërkesat për pezullimin e dënimit.....	10
<b>Pjesa e Katërt.....</b>	<b>11</b>
Menaxhimi i Parasë Publike/Buxhetit të SHKK-së.....	11
Prokurimi.....	12
Menaxhimi i Parave Private të të burgosurve.....	12
<b>Pjesa e Pestë.....</b>	<b>13</b>
Burimet Njerëzore.....	13
Statistikat e stafit sipas gjinisë dhe nacionalitetit.....	14
Ndryshimet /Lëvizjet e stafit.....	14
Ankesat e punëtorëve/personelit të SHKK-së.....	14
Masat disiplinore ndaj personelit të SHKK-së.....	14
Trajnimet e stafit.....	15
<b>Pjesa e gjashtë.....</b>	<b>17</b>
Përmisimi i kushteve të infrastrukturës për akomodim të burgosurve.....	17
Projektet e realizuara.....	17
<b>Pjesa e shtatë.....</b>	<b>19</b>
Teknologjia informative/TI në SHKK.....	19
<b>Pjesa e tetë.....</b>	<b>20</b>
Njësia për Intelegjencë.....	20
Menagjimi i të burgosurve për vepra lidhur me terrorizmin.....	20
Siguria.....	20
<b>Pjesa e nëntë.....</b>	<b>22</b>
Trajtimi/Risocializimi dhe përgaditja për riintegrim.....	22
Vlerësimi dhe Klasifikimi i të Burgosurve.....	22
Zhvillimet në kuadër të Sektorit për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve.....	23

Shkollimi në Qendrat Korrektuese të miturve.....	24
Shkollimi i të burgosurve në Q.K.Dubravë.....	25
Aftësimet profesionale dhe Programet trajnuese në Institucionet Korrektuese.....	25
Aktivitete kulturore dhe edukative.....	27
Aktivitete me të miturit e QEK jashtë Institucionit.....	28
Aktivitetet rekreative dhe sportive.....	28
Punësimi i të burgosurve.....	29
Puntoritë në Burgun e Sigurisë së Lartë.....	30
Puntoritë në Qendrën e Paraburgimit Mitrovicë.....	31
Puntoritë në Qendrën Korrektuese Smrekonicë.....	32
Donacionet e dhura nga puna e të burgosurve në Institucionet Korrektuese.....	33
<b>Pjesa e dhjetë.....</b>	<b>34</b>
Njësia Ekonomike.....	34
Njësia Ekonomike në Qendrën Korrektuese Dubravë.....	35
Njësia ekonomike në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan.....	36
Njësia ekonomike Qendrën Korrektuese për të mitur në Lipjan.....	36
Njësia Ekonomike në Qendrën Korrektuese Smrekonicë.....	37
<b>Pjesa e njëmbëdhjetë.....</b>	<b>38</b>
Statistika.....	38
Pranime.....	38
Lirimet.....	39
Lëvizjet dhe përcjelljet e të burgosurve jashtë Institucioneve Korrektues.....	40
Instituti i Psikiatrisë Forenzike – IPFK.....	40
Lëvizjet e të burgosurve nëpër spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese.....	40
Ekstradimet e të burgosurve.....	41
Pushimet e të dënuarve jashtë Institucioneve Korrektuese.....	41
Grevat e urisë.....	41
Vdekjet e të burgosurve në Qendrat Spitalore.....	41
Vetë varjet në Institucione Korrektuese.....	41
Largimet, arratisjet dhe moskthimet nga vikendi.....	41
Statistika e gjetjeve dhe parandalimit të kontrabandës në sasi në Institucionet Korrektuese.....	41
Statistika e gjetjes së kontrabandës në sasi.....	42
Gjetjet-Parandalimi i Substancave Narkotike në institucionet Korrektuese.....	42
Incidentet në Institucionet korrektuese.....	46
<b>Pjesa e dymbëdhjetë.....</b>	<b>47</b>
Donacionet e pranuar.....	47
Bashkëpunimet.....	47

## **LISTA E SHKURTESAVE**

- SHKK-Shërbimi Korrektues i Kosovës
- QK-Qendra Korrekutese
- QP-Qendra e Paraburgimit
- BSL-Burgu i Sigurisë së Lartë
- QKFL-Qendra Korrekutese për Femra në Lipjan
- QKML-Qendra Korrektuese për të mitur në Lipjan
- QEKL –Qendra Edukuese Korrektuese Lipjan
- NJPB Nga Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve
- MPPB Menagjimi i parave private të burgosurve
- NJVKB Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve
- QAP Qendra për Aftësim Profesional
- APRK Agjencioni i Punësimit të Republikës së Kosovës

## Fjala hyrëse nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm

Kam nderin dhe kënaqësinë, që në kuadër të transparencës me publikun, të paraqes raportin vjetor të punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës për vitin 2022.

Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara mbi aktivitetet dhe veprimtaritë e punës një vjeçare të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport pasqyrojnë angazhimin tonë maksimal në përmbushjen e detyrimeve si dhe identifikimin e fushave të caktuara ku nevojitet shtim i kapaciteteve tona me qëllim të ngritjes së performancës së punonjësve të SHKK-së.



Gjatë vitit 2022 SHKK ka qenë e përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve përmes trajnimeve të ndryshme profesionale, vizitave studimore, seminareve, punëtorive etj.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore këtë vit SHKK-ja ka rekrutuar 46 zyrtar korrektues dhe është në proces të rekrutimit edhe për 50 zyrtareve korrektuese.

Vlenë të theksohet se SHKK përmes aktiviteteve dhe programeve të ndryshme, krahas mbrojtjes dhe të drejtave të burgosurve, është përpjekur që të kontribuoj në rehabilitimin dhe risocializimin e personave që kanë rënë ndesh me ligjin për reintegrim të suksesshëm në shoqëri.

Falënderoj stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës për kontributin e dhënë si dhe për punën e pa lodhshme në vazhdimësi për përmbushjen e misionit tonë të përbashkët.

Sami Gashi

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm

# I. PJESA E PARË

## Përmbledhje ekzekutive

Përmbledhja ekzekutive Raporti i Punës për vitin 2022 paraqet aktivitetet dhe veprimtarinë e zhvilluar njëvjeçare të Shërbimit Korrektues të Kosovës në kuadër të realizimit të vizionit dhe mandatit kushtetues dhe ligjor, si institucion i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta.

Ky raport përbëhet nga pjesë të standardizuara të realizimit të punëve gjatë vitit 2022, të cilat pasqyrojnë aspekte të veçanta për Shërbimin Korrektues të Kosovës, me ç'rast në pjesën e parë janë paraqitur misioni, vizioni, mandati dhe fushëveprimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Në pjesën e dytë paraqitet vështrimi i përgjithshëm dhe transparenca.

Në pjesën e tretë tek çështjet ligjore është paraqitur hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore (udhëzimet administrative dhe rregullat e brendshme, vendimet, projektligjet).

Pjesa e katërt pasqyron menaxhimin e parasë publike/buxhetin e SHKK-së, aktivitetet e prokurimit si dhe menagjimin e parave private të të burgosurve.

Në pjesën e pestë janë paraqitur aktivitetet për personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si: rekrutimi, avancimi i personelit, ndryshimet/lëvizjet e stafit, masat disiplinore si dhe zhvillimi profesional i stafit.

Pjesa e gjashtë paraqet përmirësimin e kushteve të infrastrukturës për akomodim të burgosurve si dhe projektet e realizuara dhe të monitoruara nga zyra e inzhinieringut.

Pjesa e shtatë përfshinë aktivitetet dhe projektet e realizuara në Teknologjin Informativë në SHKK.

Në pjesën e tetë përfshihet Njësia për Inteligjencë, menagjimi i të burgosurve për vepra lidhur me terorizëm si dhe siguria në institucionet korrektuese.

Në pjesën e nëntë janë paraqitë të gjitha programet dhe aktivitetet për rehabilitimin dhe risocializimin e të burgosurve. Janë pasqyruar: programet rehabilituese, arsimimi i të burgosurve, programet trajnuese, punësimin, punëtoritë, aktivitetet e të miturve brenda dhe jashtë institucionit, si dhe aktivitete tjera që kanë të bëjnë me risocializimin e të burgosurve, në institucione korrektuese.

Në pjesën e dhjetë është paraqitur Njësia Ekonomike në institucionet korrektuese, statistikat dhe kalkulimet e shpenzimeve dhe të kursimeve.

Në pjesën e njëmbëdhjetë janë paraqitur statistika si: lirime, pranime, beneficionet e të dënuarve, statistikat e gjetjeve dhe parandalimit të gjërave të ndaluara në institucione korrektuese.

Në pjesën e dymbëdhjetë janë paraqitë donacionet e pranuar gjatë vitit nga institucionet dhe OJQ të ndryshme si dhe bashkëpunimet me ta.

## **Misioni**

Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet bazë në Kosovë, synon të korrektoj dhe risocializoj të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa diskriminim, si dhe kontribuon në sigurinë e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

## **Vizioni**

Krijimi dhe zhvillimi i një Shërbimi Korrektues të avancuar, i cili do të funksionojë në përputhje me ligjin, normat dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare.

## **Mandati**

SHKK është Agjenci ekzekutive e sigurisë cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka shenjën identifikuese, uniformën, flamurin dhe emblemën.

## **Fushëveprimi sipas ligjit:**

Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të të miturve dhe masave edukuese në IK përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parasheh ndryshe

Zbatimin e masës së paraburgimit sipas Kodit të Procedurës Penale;

Ndërmarrjen e masave të sigurisë për të ofruar ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për jetë dhe punë;

Ndërmarrjen veprimeve për ruajtjen e rendit, disiplinës dhe mbrojtjes së pronës në institucionet korrektuese të SHKK-së;

Vlerësimin e rrezikut dhe nevojave për trajtimin e të burgosurve;

Planifikimin, organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e programeve që i kontribuojnë risocializimit të burgosurve;

Nxitjen, motivimin dhe zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive punuese për të burgosur;

Zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e të ardhurave përmes njësisë ekonomike të SHKK-së;

Motivimin dhe krijimin e mundësive për arsimim dhe aftësim profesional për të burgosurit;

Zhvillimin profesional të personelit të SHKK-së;

Realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse dhe organizatat të cilat merren me çështjen e monitorimit e të drejtave të të burgosurve;

Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar lidhur me planin e riintegritimit pas lirimit;

Përbushjen e obligimeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.



## II.PJESA E DYTË

### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Përpos faktit që Drejtoria e Përgjithshme e SHKK-së ka përmbush përgjegjësit e saj gjatë vitit 2022 duke mbikëqyr ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njërive organizative të Shërbimit Korrektues dhe të Institucioneve Korrektuese me të cilën udhëheqë Drejtori i Përgjithshëm, i cili drejton dhe kontrollon të gjitha çështjet lidhur me Shërbimin Korrektues.

Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka ushtruar përgjegjësit e saj me integritet, duke u bazuar në Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, aktet nënligjore, rregullat e brendshme, legjislacionin tjetër në fuqi, standardet ndërkombëtare si dhe prioritetet e planit të punës së SHKK-së.

Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë kësaj periudhe, ka arritur të kryej një varg aktivitete të fushëveprimit të saj dhe sipas vlerësimit ka shënuar progres në përmbushjen e objektivave të punës si dhe ka qenë transparent për mënyrën e ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësisë që kemi ndaj të burgosurve, stafit dhe shoqërisë.

Shërbimi Korrektues i Kosovës me kapacitetet e saj të burimeve humane është angazhuar intensivisht, dhe me përkushtim maksimal profesional për të përmbushur misionin për risocializimin e personave që kanë rënë ndesh me ligjin, duke mbikëqyrur ligjshmërinë e punës për ngritjen e cilësisë të trajtimit, respektimin e dinjitetit njerëzor dhe të drejtat fundamentale të personave të privuar nga liria, përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës dhe akomodimit në kuadër të mundësive buxhetor dhe me mbështetje nga donatorët si partner strategjik të SHKK-së.

Drejtori i Përgjithshëm ka përfaqësuar Shërbimin Korrektues të Kosovës në të gjitha proceset brenda dhe jashtë vendit.

Zv.Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtoria Qendrore dhe të gjithë sektorët e saj, si dhe Drejtorët e Institucioneve Korrektuese në kuadër të përgjegjësisë, kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme për të arritur objektivat e parapara për vitin 2022 .

#### **Transparenca**

Me qëllim të rritjes së transparencës, ngritjen dhe forcimin e imazhit, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka qenë dhe vazhdon të jetë i përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediat elektronike dhe ato të shkruara. Gjatë periudhës kohore njëvjeçare, nëpër media të shkruara dhe elektronike ka pasur rreth 500 shkrime, të cilat kanë pasqyruar punën dhe aktivitetet e SHKK-së, kemi pranuar dhe jemi përgjigjur në rreth 80 kërkesa të mediave për tema të caktuara. Në web faqe të SHKK-së dhe në rrjetet sociale janë publikuar 169 lajme.

### **III. PJESA E TRETË**

#### **ÇËSHTJET LIGJORE**

Në bazë të planit të punës së Drejtoratit Ligjor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe planit të punës së Minsitrisë së Drejtësisë për vitin 2022, janë ndërmarr veprime me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe kryerjes së detyrave me përgjegjësi dhe ka arritur që të jap mbështetjen e nevojshme ligjore për funksionimin efikas të SHKK-së, duke i prezantuar të arriturat tjera vijuese:

#### **Ligje të miratuara:**

- Ligji Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- Ligji për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale.

#### **Aktet nënligjore të miratuara**

- Udhëzimi Administrativ për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së tyre periudha promovuese dhe promovimi.
- Rregulla e brendshme për Procedurat dhe Masat e Sigurisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Udhëzuesi për menaxhimin e të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor gjatë mbajtjes në institucionet korrektuese.
- Vendimi-Për listimin e mjeteve kufizuese dhe pajisjeve tjera të sigurisë të lejuara për Shërbimin Korrektues të Kosovës.
- Rregullë e brendshme: Tretmanet për të Burgosurit.

#### **Projekt Aktet nënligjore**

- Projekt Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese (është hartuar drafti fillestar).
- Projekt Udhëzimi Administrativ Për Funkcionalizimin e Njësisë së Inteligjencës(është hartuar drafti fillestar).
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Funkcionalizimin e Qendrës për Vlerësim dhe Klasifikimin(është hartuar drafti fillestar).
- Projekt rregulloren për organizmin e brendshëm të SHKK-së (është hartuar drafti fillestar).

#### **Kërkesat për faljen e dënimit:**

Gjatë vitit janë pranuar dhe përcjell tek organet kompetente 196 kërkesa për faljen e dënimit nga të dënuarit, nga falja nuk ka përfituar asnjë i dënuar.

#### **Kërkesa për pezullim dënimit:**

Janë pranuar 13 kërkesa për pezullim dënimit për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore prej të cilave - 5 kërkesa janë refuzuar, 2 kërkesa janë aprovuar , 1 i dënuar ka vdekur gjatë procedurës së pezullimit dhe 1 është pezulluar dhe pas skadimit të pezullimit është kthyer në mbajtje të dënimit.

## IV.PJESA KATËR

### Menagjimi i parasë publike-buxhetit të SHKK-së

Pasqyra e shpenzimeve të Buxhetit

- Buxheti është shpenzuar 96.58% në krahasim me Buxhetun Aktual
- Buxheti është shpenzur 100.69% në krahasim me Buxhetin Fillestar
- Projektet Kapitale janë shpenzuar 85.54 % në krahasim me buxhetin Aktual
- Projektet Kapitale janë shpenzuar 80.41 % në krahasim me buxhetin Fillestar

Përshkrimi	Buxheti Fillestar /2022	Buxheti Aktual/2022	Shpenzime	Diferenca Buxheti Fillestar / Shpenzimet	Diferenca Buxheti Aktual / Shpenzimet	Shprehur në % krahasuar me Buxhetin Fillestar	Shprehur në % krahasuar me Buxhetin Aktual
Paga dhe Mëditje	11,182,836.00	11,170,119.06	10,794,764.63	388,071.37	375,354.43	96.53	96.64
Mallëra dhe Shërbime	3,993,415.00	4,748,415.00	4,731,822.68	(738,407.68)	16,592.32	118.49	99.65
Komunali	952,969.00	1,008,456.00	951,011.95	1,957.05	57,444.05	99.79	94.30
Kapitale	1,080,000.00	1,015,131.00	868,383.46	211,616.54	146,747.54	80.41	85.54
Subvensione dhe Transfere	0,00						
Rezervat e pa-alokuar	10,000.00	10,000.00			10,000.00	0	
Të hyrat jo tatimore			-8,656.76		8,656.76		
<b>Buxheti i Përgjithshëm</b>	<b>17,219,220.00</b>	<b>17,952,121.06</b>	<b>17,337,325.96</b>	<b>(136,762.72)</b>	<b>614,795.1</b>	<b>100.69</b>	<b>96.58</b>

Prokurimi

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2022 kanë qenë të parapara gjithsej 41 aktivitete për tu zhvilluar. Tetëmbëdhjetë (18) aktivitete për Furnizime, tetë (8) aktivitete për Shërbime dhe trembëdhjetë (13) për Punë.

Janë iniciuar gjithsej 53 aktivitete.

Dymbëdhjetë (12) aktivitete janë zhvilluar jashtë planifikimit të prokurimit.

Në planifikimin e prokurimit kanë qenë tri (3) aktivitete që i ka zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 15/67 ku është miratuar lista e artikujve të përbashkët.

- Nga AQP janë nënshkruar shtatë kontrata që ndërlidhen edhe me Shërbimin Korrektues të Kosovës.
- Nga SHKK-ja janë nënshkruar gjithësejt 42 kontrata.
- Janë ndërprere katër kontrata.
- Janë anuluar shtatë aktivitete të prokurimit.

### **Menaxhimi i Parave Parave Private të të burgosurve (PPB-së)**

Bashkëpunim me MEF-in dhe bankat komerciale në vazhdimësi.

Gjatë vitit 2022 shuma e parave në llogaritë e mirëbesimit ka qenë **2,069,767.87 €**.

Shuma e mjeteve të cilat i janë kthyer të burgosurve me rastin e lirimit të tyre përmes llogarive bankare ka qenë **10,550.00 €**

Shuma e parave të transferuara nga llogaria e mirëbesimit në kodin e kantinës (kodi i të hyrave për pagesa) është: **2,059,217.87 €**.

- |                                      |                       |
|--------------------------------------|-----------------------|
| • Shpenzime për cigare               | <b>1,083,434.92 €</b> |
| • Shpenzime për ushqim               | <b>878,387.95 €</b>   |
| • Shpenzime për kartela (Phay phone) | <b>97,245.00 €</b>    |

Shuma e faturave të kantinës ka arritur në vlerë prej **2,069,767.87 €**, mjete të lira nuk kanë mbetur për bartje në vitin 2023

Sipas lëvizjeve (transfereve) të burgosurve janë kryer një numër i madh transferimeve të parave nga llogaria e një burgu në llogarinë e burgut tjetër, si më poshtë:

- **1,908** të burgosurve i janë lëvizur paratë vlera totale ka qenë **209,624.15 €**
- Shpenzimet për kartela telefonike, pako telefonike, pulla postare dhe kuverta (zarfa) kanë qenë: **97,245.00€**.


## V. PJESA E PESTË

### Burimet Njerëzore

Sektori i Burimeve Njerëzore sipas Rregullores (QRK) Nr. 31/2013 për Organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë është në kuadër të Departamentit për financa dhe shërbime të Përgjithshme.

Shërbimi Korrektues i Kosovës sipas Ligjit për Buxhetin e vitit 2022 ka pasur të aprovuara 1662 pozita, me masë buxhetore 11,182,836.00 , (ku në këtë shumë është përfshi masa buxhetore e cila është dedikuar për stafin Mjekësor të cilët punojnë në Institucionet korrektuese por janë në Kuadër te Ministrisë së Shëndetësisë). ndërsa shuma e shpenzuar për paga gjatë vitit është 10,794,764.65 €,

Kursimet apo mjetet e pa shpenzuara nga kategoria për paga dhe mëditje për periudhën e vitit 2022 kanë qenë 302,147.35€. për arsye se nuk janë plotësuar disa nga pozitat të lira për të cilat buxheti ka qenë i aprovuar, si dhe ka pasur pushime pa pagesë ,pushime të lindjes, pezullime nga puna dhe dënime disiplinore në pagë.



<i>Numri i stafi në fillim dhe në fund të vitit</i>			
Muaj	Te Aprovuara	Aktual	Të Lira
Janar	1662	1589	73
Dhjetor	1662	1591	71

Statistika e stafit në muajin dhjetor 1591 sipas gjinisë dhe nacionalitetit;

- Meshkuj 1381/86.8%
- Femra 210/13.19%
- Shqiptar 1452/ 91.26%
- Minoritete 139/8.73%

#### **Ndryshimet / Lëvizjet e stafit**

- Të punësuar si punëtor të rinj 52
- Numri i stafit të avancuar është 39
- Janë Pensionuar 22
- Kanë dhënë dorëheqje 16
- Të larguar nga komisioni 7
- Kanë ndërruar jetë 5
- Në pushim të lindjes 11 punonjëse
- Pushim pa pagesë 24
- Pensionim të parakohshëm 4
- Të pezulluar 20

#### **Ankesat e punëtorëve/personelit të SHKK-së**

Komisioni i ankesave në kuadër të SHKK-së ka pranuar gjithsejtë 37 ankesa nga personeli i Shërbimit Korrektues

- Komisioni i ankesave është shpallur Jo kompetent në 4 raste
- Ka refuzuar 33 ankesa

#### **Masat disiplinore ndaj personelit të SHKK-së**

Komisioni disiplinor ka shqiptuar këto masa disiplinore ndaj personelit të SHKK-së

- Me vërejtje 14
- Me ndalesë në pagë 36
- Me ndalim Avancimi 3
- Me ndërprerje nga puna 7
- Pezullime të përkohshme 7
- Lirim nga përgjegjësia 18

#### **Trajnimet e stafit**

	Titulli i trajnimit	Numri i trajnimeve	Numri i Pjesëmarrësve	Vendi i Realizimit
1	Projekti HOPE E djathta ekstreme në Evropën Lindore dhe Ballkan: shtrirja e kërcënimit dhe implikimet për burgun dhe dënimin me kusht	01	01	Online
2	Trajnimit për përdorim të mjeteve vlerësues për Alkool dhe Narkotik	01	10	Online
3	Trajnimit Bazik i Programit TOPs, nga Komiteti Holandez i Helsinkut	01	09	QK.Lipjan
4	Trajnimit themelor për armë të shkurta Glock 19	03	37	AKSP/QK.Dubravë
5	Hartimi i shkresave zyrtare në Administratë Publike	01	01	IKAP
6	Menaxhimi i Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë	01	14	AKSP
7	Trajnimit Komunikimi efektiv	01	01	IKAP
8	Trajnimit për trajner TOT nga Këshilli i Evropës	01	18	Online
9	Trajnimit themelor për armë automatike MP-5	03	37	AKSP/QK.Dubravë
10	Trajnimit - Disiplina dhe ankimimi në Shërbimin Civil	01	05	IKAP
11	Trajnimit Intervistimi Motivues	01	12	AKSP
12	Trajnimit Gjuhë Angleze – niveli fillestar	01	03	AKSP
13	Trajnimit Elementet Bazike të Menaxhimit	02	14	AKSP
14	Trajnimit Menaxhimi i vijës së parë	01	11	AKSP
15	Trajnimit një ditë Ndihma e parë	01	15	QK.Lipjan
16	Trajnimit 4 ditë Menaxhimi i Zemërimit	01	08	QPPrishtinë
17	Planifikimi i proceseve mësimore në Qendrat e Aftësisë Profesionale	01	05	Projekti ALLED 2
18	Trajnimit për Taktikat Mbrojtëse	01	15	AKSP/OSCE
19	Trajnimit për Administrimin e punës në zyrë	01	02	IKAP

20	Menaxhimi i vijës së mesme	01	07	AKSP
21	Mbikëqyrjen e Linjës së Parë	01	28	AKSP/OSCE
22	Trajnim Profesional për Zyrtar Korrektues	01	46	AKSP
23	Identifikimi I shenjave të radikalizmit	04	120	Këshilli I Europës
24	Përgaditja e grave për pozita lidhshme	01	04	Ambasada Britanike
26	Trajnime të ndryshme lidhur me punën e njësisë së inteligjencës (analizë, informator konfidencial etj) ku është përfshi vetëm stafi i NJIK	09	36	NIKO/ICITAP
27	Trajnime për trajnerë	01	13	ICMTC Kolorado USA
28	Trajnim për kapje dhe kontroll	01	06	West Verginia USA
29	Menaxhimi i Institucioneve Korrektuese	01	13	ICMTC Kolorado USA
30	Linjat e rrezikut të ekstremizmit-vegëza ERG 22	01	03	NICO
31	Struktura dhe funksionimi I ekipeve multidisciplinare sipas Programi për parandalim të ekstremizmit të Chanel dhunshëm	01	01	MPB
32	Ekstremizmi vendor	01	13	ICITAP
33	Zbatimi i planeve të dënimit	02	56	EULEX
34	Ngritja e aftësive të stafit të SHKK-së për ofrimin e ndihmës së parë për të burgosurit	01	13	EULEX
35	Testit të Identifikimit të Çrregullimeve të Përdorimit të Alkoolit (AUDIT) dhe Testit të Identifikimit të Çrregullimeve të Përdorimit të Drogeve (DUDIT)	01	10	EULEX
36	Trajnim për Sistem të Mbështetjes Kolegiale	01	25	EULEX

## VI. PJESA E GJASHTË



## **Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës për akomodim të burgosurve**

Divizioni i Inxhiringut ka për qëllim që hapësirat e populluara apo të banueshme nga të burgosurit dhe stafi që punon në ato hapësira ti ofrohen apo përmirësohen kushtet e jetës dhe punës në përputhje me normat ndërkombëtare, të përmirësohen kushtet hixhieniko-sanitare, krijimin e një ambienti sa më të sigurt dhe të përshtatshëm për punë dhe akomodim e të burgosurve.

Divizioni përcjell zhvillimin dhe udhëheqjen e rindërtimit, renovimit/rehabilitimit dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të gjithave renovimeve që i takojnë Shërbimit Korrektues të Kosovës. Këtu përfshihen burgjet dhe qendrat e paraburgimit, qendra korrektuese pronat e tjera zyrtare. Ndhomon Departamentet tjera në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë duke përpiluar projekte dhe mbikëqyrë projektet gjatë realizimit.

## **Projektet e realizuara**

- Renovimi i Brendshëm i Pavijonit 2 në Q.K.Dubravë,
- Renovimi i kulmeve në puntoritë e Q.K. Dubravë,
- Ndërtimi i fermës së pulave për prodhimin e vesë-faza II-të në Q.K. Dubravë
- Funksionalizimi i bllokut D në Q.K.Dubravë,
- Instalimi i bravave elektronike në Burgun e siguris së Lartë Të gjitha dyert ku janë montuar bravat elektrike janë të paisur me kontrollë të çasjes dhe mekanizëm të mbylljes si dhe të monitoruara nga dhoma e kontrollit përmes monitorit.
- Rrethimi i shëtitoreve me tel në Q.P. Prishtinë-vazhdimesi nga 2022,
- Projekti i hyrjes për vizitor dhe staf në QP Prishtinë –faza e tretë, është realizuar gjatë vitit 2022, dhe me këtë projekt është realizuar tuneli për lëvizjen e vizitorëve si dhe salla për pritjen e vizitorëve.
- Rrethoja me tel e shëtitoreve në Q.P. Gjilan furnizimi me material është bërë nga Ambasada Amerikane kurse është rregulluar nga të burgosurit.
- Projekti i rregullimit të sistemit për ngrohjen e ujit sanitar në Q.P Gjilan,
- Ndarja e hyrjes për vizitor në Q.P. Gjilan-vazhdimesi nga viti 2021,
- Rregullimi i Pompës Termike në Q.K. Lipjan.
- Rregullimi i oborrit të shëtitores në QP Prizren që përfshin rregullimin e Parkingut brenda kompleksit të Q.P. Prizren, shtrimi i shëtitores së të burgosurëve me beton dhe ndërtimi i murit ndarës me Policinë e Kosovës
- Rregullimi i ndriçimit dhe zëvendësimi i poçave me efikasitet në institucionet e SHKK

Projekti “Funksionalizimi i bllokut D në QK Dubravë” është renovuar dhe funksionalizuar me destinim të ri për trajtim të të burgosurëve me nevoja të veçanta. Është punuar në sanimin e instalimeve ujësjellës&kanalizim, nxemje qendrore, elektrike, krijimi i Liftit të ri brenda objektit , strehë të pikave vrojtuese , krijimi i rampave hyrëse dhe çasja për hendikep , ndarje të reja për staf mjekësor dhe oficer , funksionalizimi i banjove, gletimi dhe ngjyrosja e dhomave dhe korridoreve, rregullimi i dyshemeve me material epoksit etj. Një pjesë e punimeve janë kryer nga ekipet punuese të burgosurëve siç janë: dyshemeja me epoksit, gletimi dhe ngjyrosja e mureve në gjithë objektin që është i përbërë prej 10 dhomave nga ana e femrave dhe 20 dhomave (2 kate) nga ana e meshkujve, si dhe hapësirat tjera përcjellëse të nevojshme, dhe në tërësi ka një sipërfaqe të përafërme prej 3000m<sup>2</sup>.



*Foto të disa projekteve të përfunduara në Institucionet Korrektuese*

## VII. PJESA E SHTATË

### Teknologjia Informative në SHKK

Divizioni për Teknologji Informative, përveç punës së rregullt të mirëmbajtjes së rrjetit të internetit, databazës SIMB të SHKK-se gjatë kësaj periudhe 12 mujore të vitit 2022 ka realizuar këto projekte dhe aktivitete:

- Avancimi dhe menaxhimi Databazes SIMB. dhe ri-trajnimi i stafit të SHKK për përdorim të kësaj database poashtu Ndërlidhja me Databazën e Policisë së Kosovës në aspektin e shkëmbimit të dhënave për të burgosurve, përmes “view”.
- Trajnimi i stafit të SHKK për përdorim të data bazës për menaxhimin e veturave për SHKK
- Zgjerimi i sistemit VOIP për tërë SHKK.
- Zgjerimi komunikimit virtual SKYPE Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve kompjuterike për tërë Institucionet Korrektuese të SHKK-se, për komunikim virtual në mes të burgosurve dhe familjarëve të tyre.
- Zgjerimi i Rrjetit të internetit në PGJH Dubravë dhe sallë të vizitave QP Prishtinë
- Video Seancat Gjyqësore për të Burgosurit (Donacion nga ICITAP)
- Projekti i Evidentimit të zyrtarëve korrektues në pikat e kontrollit(Daister)
- Qendra Operative / Konfigurim dhe instalim i serverit për sistemin e përgjithshëm të kamerave në këtë Qendër.

## VIII. PJESA E TETË

## Njësia për Inteligjencë

Roli i Njesisë së inteligjencës korrektuese është që të ofroj informacione dhe të prodhojë produkte të inteligjencës për të ndihmuar procesin e vendimmarrjes për Drejtorin e Përgjithshëm për ruajtjen dhe ngritjen e nivelit të sigurisë në SHKK.

Raportet e Përgjithshme	Në Pritje	Raportet Pozitive	Totali
	139	84	223

## Menagjimi i të burgosurve për vepra lidhur me terrorizmin

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), aktualisht ka në mbajtje 20 të burgosur për vepra penale të terrorizmit/ekstremizmit të dhunshëm ku 14 prej tyre janë të dënuar dhe 6 janë të paraburgosur edhe pse statistikat ndryshojnë në baza ditore, të cilët janë sistemuar në BSL 6 të dënuar dhe 6 të paraburgosur si dhe 8 të dënuar në Dubravë.

Lirimet 11 total prej tyre:

- 04 të dënuar kanë përfituar lirim me kusht
- 03 të dënuar kanë përfituar lirim të mëhershëm
- 04 të dënuar kanë përfunduar dënimin
  
- Shkollimin e mesëm profesional në Q.K.Dubravë e kanë vijuar 3 të dënuar.
- Aktivitete sportive dhe rekreative për të zhvilluar punën ekipore, mirëbesimin dhe vet përmbushjen pa iu nevojitur dhuna, janë organizuar sipas rutinave ditore.
- Angazhime në punë në pacion, në punëtori, mjeshtri artizanale,

## Siguria

Duke filluar nga përgjegjësia çdo institucion korrektues ka për detyrë garantimin e sigurisë parësore për persona të privuar nga liria, për stafin dhe vizitorët. Prandaj, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka qenë i përkushtuar që institucionet korrektuese të jenë vende të sigurta për jetesë dhe pune për të gjithë popullatën e burgosur që jetojnë dhe punojnë në to duke siguruar që të mos ushtrohet asnjë lloj dhune ose kërcënim ndaj jetës dhe shëndetit.

Duke pas parasysh kërkesat e Rregullave Evropiane të Burgjeve, Neni 51 Masat e sigurisë duhet të jenë në minimumin që nevojitet, për të garantuar sigurinë e të paraburgosurve/të dënuarëve në institucion. Andaj, Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë vitit është angazhuar për të balancuar aktivitetet risocializuese dhe sigurinë. Në punën tonë të përditshme në institucione korrektuese dhe pas vlerësimit të rrezikut, masat e sigurisë janë zbatuar përmes punës kontrolluese, verifikuese dhe parandaluese, për të

ruajtur rendin dhe kontrollin e sigurisë duke garantuar një ambient të përshtatshëm për të gjithë në institucione Korrektuese.

Shërbimi Korrektues i Kosovës si rezultat i një menaxhimi efikas gjatë vitit, ka arritur që të ofroj siguri në nivel të kënaqshëm për të burgosur dhe stafin në institucione korrektuese.

Shërbimi Korrektues i Kosovës po ashtu në vazhdimësi ka ndërmarr masa të kontrollit me qëllim të parandalimit, zvogëlimin dhe eliminimin e të gjitha dukurive negative si: lëndëve narkotike, telefonave, incidenteve tjera, kontrabandën dhe elementet e tjera të ndaluara në institucione korrektuese.

Me gjithë angazhimin e instucioneve korrektuese dhe ndërmarrjen e masave të kontrollit të sigurisë për të parandaluar futjen e gjërave të ndaluara edhe këtë vit ka pasur përpjekje për futjen gjërave të ndaluara në mënyra të ndryshme në disa institucione korrektuese.

Është zhvilluar një progres edhe sa i përket kordinimit sidomos me gjetjen dhe konfiskimin e kontrabandës, identifikimin dhe kapjen në tentim për të futur kontrabandë duke e parandaluar, identifikimin dhe lëvizjen e të burgosurve të identifikuar si potencial për trazira apo prishje të rendit në institucione korrektuese.

## IX. PJESA E NËNTË

### Rehabilitimi/Risocializimi i të burgosurve dhe përgatitja për riintegrim

Shërbimi Korrektues i Kosovës mbetet i përkushtuar për ti ndihmuar të burgosurit që të ndryshojnë pozitivisht dhe të përgatiten për riintegrim në shoqëri, si individ të përgjegjshëm dhe të dobishëm për shoqërinë dhe rrethin ku do të jetojnë.

Sipas Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe akteve nënligjore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, institucionet korrektuese kujdesen për ofrimin e kushteve për të burgosurit që t'i realizojnë të drejtat e tyre për mes zhvillimit të programeve, aktiviteteve rutinore ditore brenda institucionit korrektues. Në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës janë 11 institucione korrektuese në të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme.

Veprimtaria e SHKK-së është risocializimi i personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit dhe riintegrimi i tyre në shoqëri, prandaj SHKK organizon programe të ndryshme për riedukim/risocializim për reintegrim të suksesshëm pas lirimit.

### Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve

Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve gjatë vitit 2022 ka funksionuar si pilot projekt e vendosur në hapësirat e Qendrës së Paraburgimit Prishtinë, në objektin e veçantë i dedikuar për Njësinë për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve me objektiva kryesore të vlerësimit të rrezikut për recidivizëm, identifikimin e nevojave për të dënuarit me qëllim të hartimit të planit individual të dënimit. Plani individual i dënimit është udhërrëfyese i të burgosurit për punën, angazhimin dhe pjesëmarrjen në aktivitetet, shkollimin, trajnimin dhe aftësimin në fusha të ndryshme.

NJVKB-së ka përfunduar gjithsejtë 381 vlerësime prej tyre:

- 163 raste të cilët janë paraqitur vullnetar në mbajtje të dënimit,
- 207 raste të arrestuar nga Policia dhe
- 11 raste që nga paraburgimi kanë kaluar si të dënuar
- Janë hartuar 310 planifikime të dënimit.

Në bazë të statistikave vjetore të Njesisë për Vlerësim dhe Klasifikim të të Burgosurve

- nga 0- 6 muaj janë vlerësuar 35 raste,
- nga 6 muaj-1 vit janë vlerësuar 148 raste
- nga 1-3 vite janë vlerësuar 178 raste dhe të dënuar
- mbi 3 vite janë vlerësuar 20 raste.

Tabela e rasteve të rekomanduara nga NJVKB në Institucionet Korrektuese

Nr.	Institucioni	Nr i Rasteve
1	QPPR	38
2	QKD	247
3	QKS	71
4	QPPGJ	4
5	QPPZ	17
6	QPPE	03
7	BSL	01

Nr.	Natyra e Veprave	Nr i Rasteve	%	Nr.	Institucioni	Nr i Rasteve	%
1	Vjedhje	88	23%	10	Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm	5	01%
2	Lëndime trupore	34	09%	11	Vrasje	1	00%
3	Blerje, posedim, shitje, shpërndarje e narkotikëve	62	16%	12	Vrasje në Tentativë	19	05%
4	Sulm	6	02%	13	Dhunë në familje	06	02%
5	Posedim i pa autorizuar i narkotikëve	7	02%	14	Vepra që lidhen me terrorizëm	02	01%
6	Grabitje	24	06%	15	Keqpërdorim seksuale	05	01%
7	Kanosje	4	01%	16	Dhunim	8	02%
8	Mashtrim	13	03%	17	Posedim ilegal i armëve	04	01%
9	Rrezikim i trafikut Publik	31	08%	18	Vepra tjera	62	16%

### Zhvillimet në kuadër të Sektorit për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve

Stafi Social në institucionet korrektuese ka dhënë përpjekjet maksimale për dhënjen e shërbimeve sociale për të burgosurit, duke i mbështetur gjatë qëndrimit të tyre në institucione korrektuese dhe në zhvillimin e tyre personal, social, edukues dhe profesional.

Nga stafi social janë dhënë këto programe rehabilituese psiko-sociale si me poshtë:

Nr	Programi	Institucioni	Numri i pjesmarrësve/ te burgosurve
1.	Programi "Menaxhimi i Zemërimit"	Q.K.Dubrave	28 -të dënuar madhor
		BSL	12 - të dënuar madhor
		Q.P.Prishtinë	6 - të dënuar madhor
		Gjilan	5 - të dënuar madhor
2.	Programi "Biseda për Ndryshim"	Q.E.K.Lipjan	02- të mitur
3.	"TOP'S"	Q.K.Lipjan & Q.E.K.Lipjan	14- të mitur

Gjatë këtij viti stafi social ka përcjellë parashpresa në instancat e kërkuara nga të burgosurit si në Komuna apo organizata tjera për çështje të ndryshme për të burgosurit siç janë: ndihma për veshmbathje, rregullim të dokumenteve personale për të burgosurit, për kurorëzime, për marrje pensioni, për pension të veteranit si ish pjestarë të UÇK-së, marrje shtetësisë së Kosovës, thirrje të zyrtarëve fetar, avokat etj.

Nga psikologjia e IPFK u zhvilluan 5 seanca me psikodramë për gratë e burgosura në Q.K.Lipjan.

Të dhënat statistikore për punët e realizuar nga zyrtarët social në Institucionet korrektuese të SHKK-së

Intervista & Raporte & Vizita & Kontakte me Institucione e Organizata	Numri
Intervista/biseda me të burgosur	17.997
Anamneza Sociale	3.402
Raporte: Planifikim dënimi për madhor	723
Raporte sociale për të mitur , raporte progresi për Gjykatë /Sherbim Sprovues	250
Raporte Vlerësimi për Lirim me Kusht	730
Raporte Sociale për Falje nga Presidenti	132
Raporte informuese, vlerësuese për të burgosur (për transfer, pezullim dënimi,para lirues etj)	1.204
Vizita Familjare(vizita familjeve të të burgosurve për LK, pushim jashtë burgut e arsye tjera)	188
Formulari për Pushim në Shtëpi	2.336
Formulari për Pushim të jashtëzakonshëm dhe me përcjellje	226
Formulari i Rrezikshmërisë-për kategorizim	330
Formulari për klasifikim regjimi /pavijon gjysmë i hapur	1.191
Formulari për angazhim në punë të të burgosurve	839
Formulari për vizita në lokale të veçanta	403
Takime grupore me të burgosur	34
Takime grupore me të mitur, vizita institucioneve ,vende e ngjarje me rendesi	6
Takime me familjar te te burgosurve ne institucion dhe biseda telefonike	870
Shqyrtimi i kerkesave dhe ankesave te te burgosurve	3
Stafi social si menaxher rasti, lidhur me plotësimin e nevojave të të burgosurve ka referuar rastet tek: Qendra për Punë Sociale ( 168 raste), Ambasada ( 5 raste), KMLDNJ-në (12 raste), Kryqi i Kuq Kosovar dhe Ndërkombëtar (20 raste), Qendra të Shëndetit Mendor (2 raste), Avokatin e Popullit (7 raste), OSBE-1, Dep. e Pensioneve-2.	



## **Shkollimi në Qendrat Korrektuese të miturve**

Në shkollën e mesme të ulët mësimi është zhvilluar në kuadër të SHFMU “Ismail Luma“ në Lipjan vitin shkollor 2021/2022 mësimin e kanë vijuar 11 të mitur mirëpo për shkak të lëvizjeve e kanë përfunduar vetëm 4 të mitur.

Në shkollën e mesme të lartë mësimi është zhvilluar në kuadër të shkollës “Profesionale Adem Gllavica” mesëm e kanë vijuar dhe përfunduar 7 të mitur.

Shkollimin universitar ka vijuar 1 i mitur.

Në shkollën e mesme të ulët mësimi zhvillohet në kuadër të SHFMU “Ismail Luma“ në Lipjan mësimin në vitin shkollor 2022/23 gjysëmvjetorinë e parë e kanë vijuar **23** të mitur prej tyre **10** - në klasët 6-9, niveli II.

Në shkollën e mesme të lartë (klasa 10-12) mësimi zhvillohet në kuadër të shkollës “Profesionale Adem Gllavica” në Lipjan, Lëmi i punës Makineri, Profili arsimor: Instalues i ujësjellësit, ngrohjes dhe kliamtizimit, mësimin e kanë vijuar **13** nxënës në klasët 10-12 niveli II.

Ky numër mund të ndryshoj në vazhdimësi duke pasur parasysh natyrën e institucionit tonë, lëvizjen e të miturve. Numri i mësimdhënësve të angazhuar nga DKA në Lipjan për të zhvilluar mësim në shkollën në QKML, në Nivelin II dhe Nivelin III, është **10**, të cilë janë të mjaftueshëm për mbajtjen e të gjitha lëndëve mësimore.

Shkollimin universitar i vijnë 3 të mitur.

## **Shkollimi i të burgosurve në Q.K.Dubravë**

Në shkollën e mesme të lartë profesionale “Rudina” në Qendrën Korrektuese Dubravë, e cila vepron si paralele e ndarë e shkollës së mesme të lartë “Mithat Frashëri” në Gurrakoc, vitin shkollor 2021/ 2022 e kanë regjistruar 55 nxënës, e kanë përfunduar 42 nxënës e prej tyre kanë diplomuar 07 nxënës (të dënuar). Në vitin shkollor 2022/2023 janë regjistruar 60 nxënës mirëpo për shkak të lëvizjeve dhe gjysëmvjetorin e parë e kanë përfunduar 45 nxënës.

## **Aftësimet profesionale dhe Programet trajnuese në Institucionet Korrektuese**

Rëndësia e programeve trajnuese në institucionet korrektuese qëndron tek fakti se të burgosurit/at zhvillojnë njohuri të reja dhe zgjerojnë horizontin profesional e personal. Me programet trajnuese të organizuara brenda institucioneve korrektuese SHKK synon të ndikoj drejtëpërsëdrejti në aftësimin e personave të dënuar dhe të krijoj mundësi të barabarta për pjesëmarrje aktive në shoqëri pas lirimit.

